



P7. Bujqësia, Zhvillimi Rural dhe Trajtimi i AMTP

“Mbrojtja e tokave bujqësore, reabilitimi dhe investimi në infrastrukturën bujqësore, promovimi dhe marketingu i produkteve bujqësore duke nxitur dhe mbështetur kultivimin e kulturave dhe specieve tradicionale për çdo zonë”

Përmbajtja

P7.Bujqësia, Zhvillimi Rural dhe Trajtimi i AMTP	3
1. Hyrje	3
2. Politikat e zhvillimit	3
3. Funksionet:	4
3.1. Administrimi,shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	4
3.1.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1	5
3.2. F2. Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve	5
3.2.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1.	6
3.3. F3 Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural	6
3.3.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1.	6
3.4. F4. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për zhvillimin rural të financuara nga buxheti lokal dhe /ose me bashkëfinancim nga të trete.	7
3.4.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1.	7
4. Buxheti i programit të Bujqësisë,Zhvillimit Rural dhe Trajtimit te AMTP	8
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Planifikimi për Bujqësinë,Zhvillimin Rural dhe Trajtimin e AMTP;	9

P7.Bujqësia, Zhvillimi Rural dhe Trajtimi i AMTP

1. Hyrje

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomik të Bashkisë Shkodër. Numri i fermave bujqësore është rreth 11200 dhe me drejtim kryesisht blegtoral, perime dhe fruti kulturë (për tregun lokal), me një madhësi mesatare prej 1.1 Ha/fermë e ndarë kjo në 2-3 parcela. 48% e popullsisë së Bashkisë Shkodër banon në zonat Rurale. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 16054 Ha ose 22.4% e territorit të Bashkisë, tokë subargjilore e mesme (SAM) dhe me bonitet mesatar III-IV.

Me delegimin e funksioneve të reja Bashkia Shkodër ka trashëguar kanale ujitëse 213 km, nga këta funksional 37 km dhe jo funksional 176 km, ndërsa kanale kulluese gjithsej 729.8 km nga këto 106.5 km kanale të dyta dhe 506.4 km kanale të treta kullues në pjesën më të madhe të tyre të papastruar prej vitesh.

Sot problemi kryesor mbetet fragmentarizimi i tokës, gjë e cila krijon probleme në adoptimin e skemave të subvencioneve dhe futjes së teknikave të reja (modernizimit për të qenë me konkurent në tregjet e brendshme), gjë e cila kërkon domosdoshmërisht përfundimin e procesit të rregjistrimit të tokës dhe krijimin e tregut të saj.

2. Politikat e zhvillimit

Programi vendor i bujqësisë dhe zhvillimit rural ka për qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore nga ndërtimet kaotike, saktësimin dhe regjistrimin e të drejtave të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe kategorive të tjera në hapësirën rurale, rehabilitimin dhe investimin në infrastrukturen bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore duke nxitur dhe mbështetur kultivimin e kulturave dhe specieve tradicionale për çdo zonë, ndërthurjen e investimeve në sektorin bujqësor me ato të karakterit turistik.

Programi i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimi i AMTP ka këto politika zhvillimi :

Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe të kategorive të resurseve të tjera.

Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës ekzistues, dhe zgjerimi i tyre në të gjithë territorin që mbulon Bashkia Shkodër.

Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore me masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve.

Nxitja, përmes financimit dhe këshillimit bujqësor të organizatave, shoqatave dhe kooperativave të prodhuesve bujqësore dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare.

Në kuadër të ligjit nr.139/2015 “Për qeverisjen Vendore” Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë të punojë për kryerjen e funksioneve si më poshtë. Për periudhën 2016-2019, kemi objektiva të qartë për punën tonë në përmbushjeve të detyrave funksionale.

3. Funksionet:

3.1. Administrimi,shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

F1.01. Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit.

Situata e vlerësuar/ e pritshme në fund të vitit 2017:

- Janë në proces riorganizimi 2 OPU (Postribë, Rrethinat). Në proces evidentimi dhe krijimi të 4 OPU të reja
- 15. km kanale ujitës të mirëmbajtur dhe të përmirësuar
- 55.9 km kanale kullues të mirëmbajtur dhe të përmirësuar
- 500 Ha tokë në total në situatë të përmirësuar përsa i përket ujitjes(500 Ha tokë në NJ.A. Guri i Zi, Bërdice, Rrethina)
- 2251 Ha tokë në total në situatë të përmirësuar përsa i përket kullimit (383 Ha tokë në NJ.A. Guri i Zi; 519 Ha tokë në NJ.A. Dajç; 273 Ha tokë në NJ.A. Bërdicë; 122 Ha tokë në NJ.A. Rrethina; 360 Ha tokë në NJ.A. Velipoje, 557 Ha NJ.A. Ana e Malit).

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Funksionojnë 6 shoqata dhe do krijohen dhe mbështeten 3 shoqata të reja të përdoruesve të ujit.	Funksionojnë 9 shoqata dhe do krijohen dhe mbështeten 3 shoqata të reja të përdoruesve të ujit.	Funksionojnë 9 shoqata dhe do krijohen dhe mbështeten 3 shoqata të reja të përdoruesve të ujit.
-18 km kanale ujitës të mirëmbajtur dhe të përmirësuar; -139.7 km kanale kullues të mirëmbajtur dhe të përmirësuar; 680Ha tokë në total në situatë të përmirësuar përsa i përket ujitjes;,(Postribe,Rrethinat,Bërdice); 4282 Ha tokë në total në situatë të përmirësuar përsa i përket kullimit ;(838 Ha tokë në NJA Guri i Zi;555 Ha tokë në NJA Dajç; 548 Ha tokë në NJA Bërdicë; 280 Ha tokë në NJA Rrethina; 1087 Ha tokë në NJA Velipojë, 838 Ha në NJA Ana e malit , 140 Ha NJ.A. Postribë); kosto mesatare 216 lekë/ml , kosto mesatare gjurmimi 186 lekë/m3, kosto mesatare sipërfaqe e kulluar 5709 lekë/Ha	-20 km kanale ujitës të mirëmbajtur dhe të përmirësuar; -175 km kanale kullues të mirëmbajtur dhe të përmirësuar; - 750Ha tokë në total në situatë të përmirësuar përsa i përket ujitjes;(NJA Berdice ,Dajç,Postribe,Guri i Zi,);4420 Ha tokë në total në situatë të përmirësuar përsa i përket kullimit ;(725 Ha tokë në NJA Guri i Zi; 750 Ha tokë në NJA Dajç; 655 Ha tokë në NJA Bërdicë; 320 Ha tokë në NJA Rrethina; 775 Ha tokë në NJA Ana e malit 1050 Ha tokë në NJA Velipojë, 145 Ha NJA Postribë) , kosto mesatare 236 lekë/ml , kosto mesatare gjurmimi 194 lekë/m3, kosto mesatare sipërfaqe e kulluar 5680 lekë/Ha	-25. km kanale ujitës të mirëmbajtur dhe të përmirësuar; -183 km kanale kullues të mirëmbajtur dhe të përmirësuar,kryesisht K.K.III - 950 Ha tokë në total në situatë të përmirësuar përsa i përket ujitjes;(NJA Berdice ,Dajç,Postribe,Guri i Zi); 4530 Ha tokë në total në situatë të përmirësuar përsa i përket kullimit ;(770 Ha tokë në NJA Guri i Zi; 830 Ha tokë në NJA Dajç; 765 Ha tokë në NJA Bërdicë; 465 Ha tokë në NJA Rrethina; 480 Ha tokë në NJA Ana e malit 1100 Ha tokë në NJA Velipojë 120 Ha NJA Postribë); kosto mesatare 165 lekë/ml , kosto mesatare gjurmimi 174 lekë/m3, kosto mesatare sipërfaqe e kulluar 5676 lekë/Ha

3.1.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë 2018	Buxheti në mijë lekë 2019	Buxheti në mijë lekë 2020
P7.F1.O1.A1 Menaxhimi dhe funksionimi i D.SH.B.P.	13,501	13,542	14,395
P7.F1.O1.A2 Përmirësimi dhe fuqizimi i parkut të mjeteve të D.Sh.B.P.	0	11.000	0
P7.F1.O1.A3 Nxitja e krijimit të Shoqatave të Përdoruesve të Ujit në çdo Nj.A. dhe trainimi i tyre	306	312	318
P7.F1.O1.A4 Studimi i skemave të ujitjes dhe kullimit në 5 Nj.A.	0	0	0
P7.F1.O1.A5 Pastrim kanalesh kulluese dhe ujitëse në Nj.A.	12,229	12,229	12,671
P7.F1.O1.A6 Mirembajtje e skemës ujitëse	7,346	7,328	7.898
P7.F1.O1.A7 Zbatimi i projekteve teknike prioritare për sistemin e ujitjes ,kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni	0	0	0

3.2. F2. Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve

F2.O1 Krijimi i sistemit të informacionit për administrimin, përdorimin e tokës mbështetur në teknologji bashkëkohore. Plotësimi i dokumentacioneve përkatëse të pronësive private Situata e vlerësuar/ e pritshme në fund të 2017;

- Një regjistër me të dhëna të plota kadastrale.
- Një regjistër me të dhëna të plota të pronave bujqësore.
- Për të gjitha njësitë ka përfunduar plotësimi me AMTP.
- Në dy fshatra në Nj.A. Dajç ka përfunduar plotësimi me AMTP.
- Në Velipojë ka përfunduar plotësimi me AMTP.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Regjistër kadastral i përditësuar	Regjistër kadastral i përditësuar	Regjistër kadastral i përditësuar
Përditësim i regjistrit të pronave bujqësore	Përditësim i regjistrit të pronave bujqësore.	Përditësim i regjistrit të pronave bujqësore
Plan rievimeve te parcelave bujqësore. 210 plan rievime	Plan rievimeve te parcelave bujqësore. 230 plan rievime	Plan rievimeve te parcelave bujqësore. 250 plan rievime

3.2.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë 2018	Buxheti në mijë lekë 2019	Buxheti në mijë lekë 2020
P7.F2.O1.A1 Krijimi i kadastres bujqësore dhe arshivës së saj dhe futja në sistem e zonave të parilevuara.	902	904	962
P7.F2.O1.A2 Database i dedikuar për të dhëna të kadastrës rurale.	-	-	-
P7.F2.O1.A3 Mbështetja e regjistrimit të pronave me shpenzimet e Bashkisë	510	520	530

3.3. F3 Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural

F3.O1 Krijimi i databazës së informacionit bujqësor. Krijimi i strukturës këshillimit bujqësor. Situata e vlerësuar/ e pritshme në fund të vitit 2017:

- Krijimi i regjistrit bujqësor. Promovimi i teknologjive të reja. Përmirësim i organizimit të njësive bujqësore në SH.B.B. Bashkëpunimi i njësive bujqësore me agro-përpunues, tregtar inputesh dhe produktesh bujqësore.

Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019	Situata e synuar 2020
Përditësimi i regjistrit bujqësor; Promovimi i teknologjive të reja. -Përmirësim i organizimit të njësive bujqësore në SH.B.B. Bashkëpunimi i njësive bujqësore me agro-përpunues, tregtar inputesh dhe produktesh bujqësore.	Vazhdimësi e përditësimit i regjistrit bujqësor. -Promovimi i teknologjive të reja; Përmirësim i organizimit të njësive bujqësore në SH.B.B. Bashkëpunimi i njësive bujqësore me agro-përpunues, tregtar inputesh dhe produktesh bujqësore.	Përditësimi i mëtejshëm i regjistrit bujqësor. -Promovimi i teknologjive të reja; Përmirësim i organizimit të njësive bujqësore në SH.B.B. Bashkëpunimi i njësive bujqësore me agro-përpunues, tregtar inputesh dhe produktesh bujqësore.

3.3.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë 2018	Buxheti në mijë lekë 2019	Buxheti në mijë lekë 2020
P7.F3.O1.A1 Krijimi i informacionit bujqësor.			
P7.F3.O1.A2 Sigurimi i mbështetjes së fermerëve për agro-industrinë, treg dhe marketing.			
P7.F3.O1.A3 Promovimi dhe krijimi i			

SH.B.B. ose grupeve prodhuese e tregtuese.

P7.F3.O1.A4 Promovim produktesh bujqësore dhe blegtorale nëpërmjet panairove.

- - -

3.4. F4. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për zhvillimin rural të financuara nga buxheti lokal dhe /ose me bashkëfinancim nga të treta.

F4.O1 Përthithja e granteve nga programet për zhvillimin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural Situata e vlerësuar/e pritshme në fund të vitit 2017:

- Mbështetje dhe orientim për rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga Programi i mbështetjes së qeverisë shqiptare.
- Rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga programi SARED.
- Rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga programi IPARD.
- Rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga programi GIZ.
- Rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga Programi i përmirësimit të ujitjes.

Situata e synuar 2018

Situata e synuar 2019

Situata e synuar 2020

Mbështetje dhe orientim për rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga programi i mbështetjes së qeverisë shqiptare.
Rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga programi SARED.
Rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga programi IPARD.
Rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga programi GIZ.
Rritjen e numrit të përfituesve individual, Sh.B.B dhe agropërpunues të mbështetur nga programi i përmirësimit të ujitjes.

3.4.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1.


Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë 2018	Buxheti në mijë lekë 2019	Buxheti në mijë lekë 2020
P7.F4.O1.A1 Promovim dhe asistencë teknike në hartim projekte, plan biznese për përthithje të granteve.	-	-	-

4. Buxheti i programit të Bujqësisë,Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Bujqësisë,Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP planifikohet buxheti me vlerë totale 34,794 mijë lekë, ndër të cilat 34 % paga dhe sigurime shoqërore, 67 % shpenzime operative.

Tabelë 1 Planifikimi për Bujqësinë,Zhvillimin Rural dhe Trajmin e AMTP.

Programi P7	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Totali
Plani 2017	10,928	18,370	0	50	4,040	33,388
Plani 2018	11,736	23,058	0	0	0	34,794
Plani 2019	11,777	23,058	0	0	11.000	45,835
Plani 2020	12,505	24,269	0	0	0	36,774



Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Planifikimi për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Trajtimin e AMTP;

Nr. 1	P7.F1.O1.A1 Menaxhimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore.	Llojet e programit: P7. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural Funksioni: P7.F1. Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit: Menaxhimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore.		
i. Situata		
<p>Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, pika 1: Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.</p> <p>Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 1108, datë 30.12.2015, “Transferimi, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, ka kaluar në administrim të Bashkisë Bordin e Kullimit i cili me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Shkodër Nr. 14 datë 19/01/2016 ka krijuar Drejtorinë e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore.</p> <p>Për realizimin e këtij shërbimi përveç strukturës së brëndshme të Bashkisë së Shkodrës, që ndjek politikat vendore, harton programin e ndërhyrjes, termat e referencës dhe standartet, funksionon edhe Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore me sektorin e Ujitjes dhe Kullimit e përbërë nga 12 punonjës, teknikë dhe punëtorë të cilët kanë detyrë të kryejnë dhe të ndjekin në territor zbatimin e punimeve që kryhen për pastrimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese.</p> <p>Fondet e parashikuara për funksionimin e strukturës dhe për pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve kulluese rezultojnë si në tabelën më poshtë:</p> <p>Me kalimin e funksionit të ujitjes dhe kullimit, sipas ligjshmërisë të paraqitur më sipër, duhet të ndërhyhet me pastrime dhe riparime sipas nevojës dhe rast pas rasti në kanale ujitëse dhe kulluese në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës. Ndërhyrja për pastrimin e kanaleve kulluese siguron mbajtjen në nivelet optimale të ujërave duke eliminuar si dëmtimin e bimeve të mbjellura nga fermerët ashtu edhe të strukturës së tokës në vetvete.</p> <p>Ndërhyrja në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse, dhe veprave të artit që sigurojnë mirëfunksionimin e tyre, është e domosdoshme për të bërë të mundur realizimin e rendimenteve të parashikuara nga fermerët për kulturat e ndryshme bujqësore.</p> <p>Ndërhyrja në mirëmbajtjen e argjinaturave, përveç mbajtjes nën kontroll të tyre, parashikon dhe mirëmbajtje të pjesëshme sipas rregullores së mirëmbajtjes së veprave të mbrojtjes nga lumenjtë.</p> <p>Në të tre rastet duhet të ndërhyhet me puntori dhe me mjete të mekanizuara sipas grafikëve që struktura përkatëse do të parashikojë.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Evidentimi në vazhdimësi i problematikave kryesore të sistemit ujitës dhe kullues • Hartimi i planeve të ndërhyrjeve për pastrim dhe rehabilitim Kanaleve Ujitëse dhe Kanaleve Kulluese . • Përcaktimi i vëllimeve të punës në objektet ku do të ndërhyhet. • Kryerje e punimeve për pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve ujitëse dhe kanaleve kulluese 		
b) Rezultatet që prisni		
<ul style="list-style-type: none"> • Funksionim i mirë i strukturs së ujitjes dhe kullimit • Kryerje sipas kërkesave dhe vlerësimit të shërbimit për pastrim dhe rehabilitim Kanaleve Ujitëse dhe Kanaleve Kulluese • Ujitja kryhet në kohë dhe me sasinë dhe cilësinë e kërkuar 		
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt	
Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-ve	Bashkia Shkodër	
e) Shpenzimet e llogaritura		



Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Procedurë përgatitore						
A.2	Paga, kontribute dhe sigurime shoqërore	11,736	9,776	1,960			
A.3	Shpenzime për marrje me qera mj.transp	765			765		
A.4	Shpenzime lubrifikant	300			300		
A.5	Shpenzime pjesë këmbimi	300			300		
A.6	Shpenzime për të tretë	400			400		
	Shuma	13,501	9,776	1,960	1,765		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Procedurë përgatitore						
A.2	Paga, kontribute dhe sigurime shoqërore	11,777	9,810	1,967			
A.3	Shpenzime për marrje me qera mj.transp	765			765		
A.4	Shpenzime lubrifikant	300			300		
A.5	Shpenzime pjesë këmbimi	300			300		
A.6	Shpenzime për të tretë	400			400		
	Shuma	13,542	9,810	1,967	1,765		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Procedurë përgatitore						
A.2	Paga, kontribute dhe sigurime shoqërore	12,505	10,417	2,088			
	Shpenzime për marrje me qera mj.transp	790			790		
A.3.3	Shpenzime lubrifikant	300			300		
A.3.4	Shpenzime pjesë këmbimi	400			400		
A.3.5	Shpenzime për të tretë	400			400		
	Shuma	14,395	10,417	2,088	1,890		
f) Periudha e zbatimit Janar 2018 – Dhjetor 2020		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Bujqësisë , Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP. Institucioni likuidues : Drejtorja e shërbimeve bujësore dhe pyjore.					

Nr. 2	P7.F1.O1.A2 Përmirësimi dhe fuqizimi i parkut të mjeteve të Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore .	Llojet e programit: P7. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural Funksioni:P7.F1. Administrimi,shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastruktures së ujitjes dhe kullimit				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Në zbatim të V.K.M. Nr. 1108 datë 30/12/2015 dhe Udhëzuesit AZRT-së Nr. 540/1 datë 31/12/2015 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të funksionit të kullimit me Urdhërin e Brëndshëm Nr. 3 datë 12/01/2016. Procesi i marrjes në dorëzim të aseteve të ish Bordit të Kullimit Shkoder ka përfunduar me datë 31/05/2016. Si rezultat i këtij procesi Bashkia Shkodër nuk ka të trashëguar: asnjë mjet eskavator, shtrat eskavatori , kamion , apo mjete të tjera për ushtrimin e funksioneve të ujitjes dhe kullimit të deleguara me ligj. Gjithashtu, strukturat ndihmëse të trashëguara si magazina, ofcina riparimi etj janë në gjëndje jo funksionale si dhe pronësia e truallit të këtyre aseteve është në pronësi të individëve privat.</p> <p>Në vijim të prokurimit të realizuar nga Ministria e Bujqësisë,Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave në zbatim të VKM 90 datë 4.2.2016, jemi furnizuar me dy eskavatorë me zinxhirë Volvo EC220D dhe Volvo ECR88D të cilët janë marrë në dorëzim në zbatim të urdhërit të brëndshëm Nr 85 datë 10/02/2017 të Kryetarit të Bashkise. Meqënëse eksavatorët janë me zinxhirë dhe kërkohet lëvizja e tyre edhe përgjatë rrugëve nacionale del e nevojshme blerja e një shtrati eskavatori për të bërë të mundur transportin e tyre në destinacionet e punës si dhe një kamion vetëshkarkues i cili të bëjë transportin si të mjeteve ashtu dhe të mbetjeve për ku është e nevojshme. Gjithashtu në vijim parashikohet blerja e një eskavatori tjetër .</p>						
ii. Synimi i projektit						
Rritja e efieneses së sektorit të ujitjes dhe kullimit të Drejtorisë se Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Blerje mjete (shtrat eskavatori, kamion transporti, mjet 4x4 , kamion veteshkarkues) 						
b) Rezultatet që prisni						
Krijimi i nje parku mjetesh dhe strukture ndihmëse efikase në sherbim te funksionit te ujitjes dhe kullimit						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Drejtoria Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore ,. Bashkia Shkodër						
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Blerje mjetesh	0				0
	Shuma	0				0
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Blerje mjetesh	11.000				11.000
	Shuma	11.000				11.000
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Janar 2019 – Dhjetor 2019				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Bashkia Shkoder Instucioni likuidues : Bashkia Shkodër		

Nr.3	P7.F1.O1.A3 Nxitja e krijimit te SH P Ujit në çdo Nj.A dhe trainimi i tyre	Llojet e programit: P7. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural Funksioni:P7.F1. Administrimi,shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
------	--	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Bashkia Shkodër ka një sipërfaqe të konsiderueshme toke bujqësore dhe larmi prodhimesh bujqësore. Rritja e prodhimit kërkon përmirësimin e strukturave të ujitjes.Aktualisht me infrastrukturën ekzistuese mbulohet me ujitje rreth 40% e sipërfaqes së tokës bujqësore.
Një nga problemet kryesore është menaxhimi i ujitjes së tokave bujqësore.Problematika është vertetë e madhe për faktin se nuk ka O.P.U. të krijuara (përvec Nj.A. Postribë) që të realizojnë kontratat e marrjes dhe administrimit të ujit sipas ligjit Nr. 45/2017 E vetmja O.P.U. e ngritur në Nj. A. Postribë nuk është e vënë plotësisht në funksion. Ka mungesa të theksuara të njohjes së ligjit të ujitjes për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes të transferuar në përdorim brënda zonës së saj të shërbimit dhe sigurimit të ujit për ujitje per anëtarët e saj.

ii. Synimi i projektit

Krijimi i O.P.U.-ve ne cdo Njësi Administrative dhe trainimi i tyre për menaxhimin e ujit dhe mirëmbajtjen e sistemit ujitës.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Evidentim i zonave të ujitjes dhe kërkesave të tyre për ujitje ne cdo Njësi Administrative
- Evidentimi i personave me aftësi të mira menaxhuese që do jenë pjese e O.P.U. në cdo Njësi Administrative
- Shqyrtimi i realizueshmërisë hidraulike dhe ekonomike të zonës së shërbimit të ujitjes .
- Organizimi i grupit nismëtar për ngritjen e O.P.U.
- Asistence në hartimin e statutit, dokumentacionit mbështetës dhe mënyrës së funksionimit të O.P.U. ne vazhdimësi.

b) Rezultatet që prisni

Krijimi, funksionimi efikas i O.P.U.-ve në cdo Njësi Administrative ose/apo zonë ujitjeje.

c) Aktorët e mundshëm

Njesite Administrative , Drejtoria e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP, Fermere të Nj.A.

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Evidentim i zonave të ujitjes						
A.2	Organizimi i grupit nismëtar për ngritjen O.P.U.						
A.3	Asistence në hartimin e statutit, dokumentacionit mbështetës	306			306		
	Shuma	306			306		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
A.1	Evidentim i zonave të ujitjes						
A.2	Organizimi i grupit nismëtar për ngritjen O.P.U.						
A.3	Asistence në hartimin e statutit, dokumentacionit mbështetës	312			312		
	Shuma	312			312		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale



			e			
A.1	Evidentim i zonave te ujitjes					
A.2	Organizimi i grupit nismetar për ngritjen O.P.U.					
A.3	Asistencë në hartimin e statutit, dokumentacionit mbështetës	318			318	
	Shuma	318			318	
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Janar 2018 – Dhjetor 2020			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP , Bashkia Shkodër. Instucioni likuidues : Bashkia Shkodër			

Nr. 4	P7.F1.O1.A4 Studimi i skemave të ujitjes dhe kullimit në 5 Nj.A.	Llojet e programit: P7. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural Funksioni:P7.F1. Administrimi,shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Në Nj.A. Pult, Shalë, Shosh, Ana e Malit dhe pjesërisht Dajç mungojnë studime të skemave të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore.Mungesa e këtyre skemave ka sjellë problematika në zhvillimin bujqësor prandaj nevojitet një analizë e mbështetur në të dhëna sasiore, reale dhe të argumentuara për territorin.						
ii. Synimi i projektit						
Përfundimi i studimit të skemave të sistemit të ujitjes dhe kullimit përfundimtar për Bashkinë Shkodër.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Evidentimi i zonave për ujitje dhe kullim në 5 (pesë) Njësi Administrative. Studimi i skemave të ujitjes dhe kullimit në 5 (pesë) Njësi Administrative. 						
b) Rezultatet që prisni						
Përfundimi përfundimtar i studimeve të skemave të ujitjes dhe kullimit për Njësitë Administrative.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Njësi Administrative, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP , Studio studimi dhe projektimi.				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Studim skemash					
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Studim skemash					
	Shuma					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Studim skemash					
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Janar 2018 – Dhjetor 2020				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP. Instucioni likuidues : Bashkia Shkodër		

Nr.5	P7.F1.O1.A5 Pastrim kanalesh kulluese dhe ujitëse në Nj.A.	Llojet e programit: P7. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural Funksioni:P7.F1. Administrimi,shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Ujitja dhe kullimi janë ndër faktorët kryesorë të rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend, por për shkak të mungesës së vazhdueshme të investimeve, ky sektor ka mbetur akoma në gjendje kritike.</p> <p>Në sistemin e kullimit dhe ujitjes që mbulon Bashkia Shkodër, janë gjithsej 729 km kanale të II dhe të III kulluese dhe 213 km kanale ujitës. Si rezultat i mungesës së investimeve në sistemin e kullimit dhe ujitjes, situata në KU – II/ III dhe KK – II/III është tejte e rënduar dhe pothuajse jashtë funksionit. Kanalet e III-ta kullues nuk janë pastruar pothuajse asnjëherë dhe janë shtuar aluvionet nga toka, barërat e këqia e lëndë të tjera inerte. Mungesat janë të theksuara në sistemin dhe pastrimin e tyre, në veprat e artit si tombino, ura, sifona etj, që kanë çuar në mosfunksionimin e tyre. Kjo ka bërë që sipërfaqe të tëra bujqësore të mos kultivohen ose të japin prodhime minimale.</p> <p>Në bazë të igjit Nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, pika1: <i>Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj</i>”.</p> <p>Kalimi i funksionit të ujitjes dhe kullimit në Bashki (VKM nr.1108,datë30.12.2015; Ligji nr 147/2015 “ Për buxhetin e vitit 2016”, Neni 15), ka sjellë studimin e situatës dhe caktimin e ndërhyrjeve prioritare për të gjitha NJA. Këto ndërhyrje do të konsistojnë në pastrime dhe riparime sipas nevojës dhe rast pas rasti në kanale ujitës dhe kullues në të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës. Ndërhyrja për pastrimin e kanaleve kullues do të sigurojë mbajtjen në nivelet optimale të ujrave duke eliminuar si dëmtimin e bimeve të mbjellura nga fermerët ashtu edhe të strukturës së tokës në vetvete.</p>						
ii. Synimi i projektit						
Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit dytësor dhe terciar të ujitjes dhe kullimit, do të rrisë dukshëm shërbimet në favor të fermerëve dhe zhvillimit rural						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Hartimi dhe zbatimi i grafikëve të ndërhyrjes për KU – II/ III dhe KK – II/III Përcaktimi i volumeve të punës Pastrimi dhe ndërhyrja me puntori dhe me mjete të mekanizuara sipas grafikëve që struktura përkatëse do parashikojë.						
b) Rezultatet që prisni						
Sistemi i kanaleve të ujitjes dhe kullimit më problematike të NJA i përmirësuar .						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Bujqësisë,Zhvillimit Rural dhe Trajtimit te AMTP. Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore. 			Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Shpenzime karburanti	12.229		12.229		
Shuma		12.229		12.229		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë))	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime kapitale
A.1	Shpenzime karburanti	12.229		12.229		
A.2						
A.3						
Shuma		12.229		12.229		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale



A.1	Shpenzime karburanti	12.671			12.671		
A.2							
A.3							
	Shuma	12.671			12.671		
f) Periudha e zbatimit Janar 2018 - Dhjetor 2020		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP. Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore. Institucioni likuidues : Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore.					



Nr. 6	P7.F1.O1.A6 Mirëmbajtje e skemës ujitëse.	Llojet e programit: P7. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural Funksioni:P7.F1. Administrimi,shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Bujqësia është një ndër sektorët ekonomikë më të rëndësishëm të Bashkisë Shkodër. Sipërfaqja tokës bujqësore e bashkisë është 16 054 ha ose 22.4% e sipërfaqes se territorit të Bashkisë. Njëkohësisht bashkia Shkodër, ka një potenciali mjaft të madh ujqor, i cili mund të përdoret për ujitjen e tokave bujqësore. Me kalimin e funksioneve të reja, është dhe administrimi shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastruktures së ujitjes dhe kullimit. Bashkia Shkoder, ka trashëguar 213 km kanale ujitëse nga të cilat funksionale janë 37 km dhe jo funksionale 176 km. Që nga marrja në inventar të sistemit ujitës/kullues Bashkia Shkodër ka ndërhyrë për përmirësimin e rrjetit ujitës duke mirëmbajtur rreth 15 km kanale ujitës. Siperfaqja që vaditet aktualisht është rreth 40% e sipërfaqes të mundshme për vaditje. Prandaj, lind nevoja për plotësim me ujë nëpërmjet mirëmbajtjes tërësore dhe modernizimit të sistemit ujitës të sipërfaqeve të tokave bujqësore që aktualisht kanë nevoja për ujë por që nuk ujitjen.						
ii. Synimi i projektit						
Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore dhe rritja e rendimenteve në bujqësi, përmirësimi i standartit të jetesës së fermerëve						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Evidentimi i segmenteve të kanaleve ujitëse ku do të ndërhyhet Përfundimi i projektit teknik me rishikimin e preventivit dhe të volumeve të punës dhe të analizës. Përpilimi i dokumentacionit të nevojshëm për ndërhyrje Fillimi i punimeve si dhe përfundimi i tyre në segmentet e përcaktuara për rehabilitim						
b) Rezultatet që prisni						
Mirëmbajtje e segmenteve më të dëmtuara që kanë nevoja për ndërhyrje emergjente, të kanaleve ujitëse						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
